

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 8, datë 19.7.2022

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR KRYERJEN E SHËRBIMIT TË PËRKTHIMIT ZYRTAR DHE INTERPRETIMIT TË GJUHËS SË SHENJAVE DHE RREGULLAVE PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E TARIFAVE PËR KATEGORI TË PERSONAVE PËRFITUES TË NDIHMËS JURIDIKE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

I. Objekti

Ky udhëzim përcakton tarifat për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullat për përfitimin e uljes së tarifave të shërbimit ose përjashtimin nga pagesa e këtyre tarifave për kategoritë e personave përfitues të ndihmës juridike, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

II. Tarifat për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar

1. Masa e tarifës për shërbimin e përkthimit të një teksti, dokumenti zyrtar ose i një akti normativ të miratuar në Republikën e Shqipërisë, i një marrëveshjeje ndërkombëtare ose normave të nxjerra nga organizatat ndërkombëtare, me shkrim, nga gjuha e burimit në gjuhën e synuar, llogaritet për faqe kompjuterike.

2. Faqja kompjuterike përmban 1800 (një mijë e tetëqind) shkronja e shenja, duke përfshirë dhe ndarjet e nevojshme të materialit të shkruar në fjalë, kryeradhë, paragrafë, kapituj dhe pjesë. Skicat, fotot, tabelat e skemat që përfshihen në tekstin e përkthyer, llogariten e shpërblehen mekanikisht si faqe kompjuterike sipas vendit që zënë në tekst.

3. Tarifa e shërbimit të përkthimit me shkrim, nga gjuha shqipe në gjuhën e huaj është 1600 (një mijë e gjashtëqind) lekë për çdo faqe, pa përfshirë TVSH.

4. Tarifa e shërbimit të përkthimit me shkrim, të dokumenteve zyrtare nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe është 1300 (një mijë e treqind) lekë për çdo faqe, pa përfshirë TVSH.

5. Masa e tarifës për shërbimin e përkthimit me gojë, kur palët nuk dinë gjuhën shqipe, gjatë hetimit të një çështjeje penale, si dhe gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore civile, penale ose administrative, sipas parashikimeve të legjislacionit procedural në fuqi ose gjatë shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese llogaritet në bazë të një kohëzgjatje prej një ore.

6. Tarifa e shërbimit të përkthimit me gojë është 4200 (katër mijë e dyqind) lekë për çdo orë përkthimi, pa përfshirë TVSH. Në rastet kur përkthimi zgjat më pak ose më shumë se një orë, tarifa e përkthimit llogaritet në proporcion me kohëzgjatjen e përkthimit.

III. Tarifat për kryerjen e shërbimit të interpretimit të gjuhës së shenjave

1. Masa e tarifës për shërbimin e interpretimit të gjuhës së shenjave shqipe gjatë hetimit të një çështjeje penale, si dhe gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore civile, penale ose administrative, sipas parashikimeve të legjislacionit procedural në fuqi ose gjatë shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese, llogaritet në bazë të një kohëzgjatje prej një ore.

2. Tarifa e shërbimit të interpretimit të gjuhës së shenjave për një kohëzgjatje prej një ore është 4200 (katër mijë e dyqind) lekë për çdo orë përkthimi, pa përfshirë TVSH lekë. Në rastet kur interpretimi zgjat më pak ose më shumë se një orë, tarifa e interpretimit llogaritet në proporcion me kohëzgjatjen e përkthimit.

IV. Ulja e tarifave dhe përjashtimi nga pagesa e tarifave

1. Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike, sipas nenit 11, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përfitojnë ulje në masën 50 për qind të masës së tarifës së shërbimit të përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave.

2. Personat me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme, sipas nenit 12 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përjashtohen nga pagesa e tarifave të shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave, kur provohet përmbushja e kushteve për të përfituar ndihmën juridike.

V. Procedura e shqyrtimit të kërkesës për uljen e tarifave ose përjashtimin nga pagesa e tyre

1. Personi, i cili kërkon të përfitojë uljen e tarifave të shërbimit të përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave ose përjashtimin nga pagesa e tyre, plotëson dhe paraqet pranë Ministrisë së Drejtësisë formularët, sipas shtojcave 1, 2 dhe 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse të tij, si dhe dokumentacionin shoqërues, që provon përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Struktura përgjegjëse për përkthimin zyrtar pranë Ministrisë së Drejtësisë verifikon plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të formularëve, në përputhje me parimet dhe rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative.

3. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kushteve, nuk është i plotë, i saktë ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga kërkuesi, çdo organ publik apo persona të tjerë juridikë, vendës ose të huaj.

4. Në përfundim të verifikimit mbi plotësimin kushteve, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë harton dhe përcjell për miratim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, relacionin shpjegues për çdo kërkues ku pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe arsyet mbi propozimin për pranimin ose refuzimin e kërkesës për përfitimin e uljes së tarifave të shërbimit të përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave ose përjashtimin nga pagesa e tyre, si dhe njoftimin përkatës mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve. Vendimi i miratuar i njoftohet zyrtarisht kërkuesit.

5. Kërkuesi, të cilit i është refuzuar kërkesa, ka të drejtë të paraqesë ankim pranë ministrit të Drejtësisë brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, duke bashkëlidhur argumentet dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kriterëve për uljen e tarifave të shërbimit të përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave ose përjashtimin nga pagesa e tyre.

6. Grupi i punës i ngritur me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë shqyrton ankimin dhe i propozon ministrit të Drejtësisë pranimin e kërkesës, në rastet kur provohet përmbushja e kushteve, ose refuzimin e ankimit. Ministri i Drejtësisë nxjerr urdhrin përkatës jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së ankimit.

7. Personi i cili përfiton uljen e tarifave të shërbimit të përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave ose përjashtimin nga pagesa e tyre njofton përkthyesin zyrtar ose interpretin e gjuhës së shenjave të zgjedhur prej tij dhe i vendos në dispozicion një kopje të njoftimit ose të urdhrin të ministrit të Drejtësisë.

8. Pas kryerjes së shërbimit, përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave i paraqet Ministrisë së Drejtësisë kërkesën për kompensimin e tarifës së shërbimit të kryer, të shoqëruar me:

- a) deklaratën që i bashkëlidhet përkthimit zyrtar;
- b) faturën tatimore për ofrimin e shërbimit, kur kërkuesi ka përfituar nga ulja e tarifës;
- c) deklaratën me shkrim të kërkuesit mbi marrjen e shërbimit sipas shtojcës 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij, kur është përjashtuar nga pagesa e tarifës;
- ç) të dhënat e llogarisë bankare të bankës së nivelit të dytë ku kryhet kompensimi.

9. Pas verifikimit të dokumentacionit, sipas pikës 8 të këtij kreu, Ministria e Drejtësisë kompenson përkthyesin zyrtar ose interpretin e gjuhës së shenjave në masën 50 për qind të tarifës kur është përfituar ulja e saj ose në masën 100 për qind të tarifës, në rastin kur kërkuesi është përjashtuar nga

pagesa e tarifës. Kompensimi mbulohet nga buxheti i miratuar i Ministrisë së Drejtësisë dhe derdhet në llogarinë bankare të përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave.

VI. Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Ky udhëzim zbatohet për të gjitha shërbimet e përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave që kryhen pas hyrjes në fuqi të tij.

2. Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave nr. 3165, datë 12.5.2004, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, përkthyesit zyrtarë dhe interpretët e gjuhës së shenjave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I FINANCave DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj



Shtojca nr. 1

FORMULAR KËRKESE

PËR PËRFITIMIN E ULJES SË TARIFËS OSE
PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E TARIFËS SË
SHËRBIMIT TË PËRKTHIMIT ZYRTAR OSE
INTERPRETIMIT TË GJUHËS SË SHENJAVE

Datë:

RUBRIKA 1: TË DHËNAT E KËRKUESIT:

Emri: _____
Atësia: _____
Mbiemri: _____
Datëlindja: _____
Vendlindja: _____
Numri i identifikimit: _____
Gjendja Civile: ☐ i/e martuar ☐ i/e ve ☐ beqar/e ☐ i/e divorcuar

Shtetësia: _____
Qëndrimi në Shqipëri:
(leje qëndrimi - i
përkohshëm):
① Nëse nuk keni shtetësi
shqiptare.

Vendbanimi: _____
Adresa: _____
Kodi
postar: _____
Qyteti: _____
Shteti: _____

Adresa për korrespondencë: _____
① Nëse është e ndryshme
nga më sipër _____
Adresa: _____
Kodi
postar: _____
Qyteti: _____
Shteti: _____

Numri i kontaktit: _____
Adresa elektronike: _____

RUBRIKA 2: CILËSIA E PËRFITUESIT

2.1 A bëni pjesë në një prej kategorive të veçanta të përfituesve të ndihmës juridike? ☐ Po ☐ Jo

Nëse po, citoni kategorinë:

 (plotëso dhe bashkëlidh Formularin e Vetëdeklarimit për Kategoritë e Veçanta).

2.2 A bëni pjesë në kategorinë e përfituesve të ndihmës juridike për shkak të të ardhurave dhe pasurive të pamjaftueshme? ☐ Po ☐ Jo

Nëse po, deklaroni të ardhurat dhe pasuritë tuaja:

 (plotëso dhe bashkëlidh Formularin e Vetëdeklarimit të të Ardhurave dhe Pasurive).

2.2.1 Për kërkuesin që jeton vetëm:

- Të ardhurat e mia janë nën vlerën e pagës minimale mujore të përcaktuar me ligj.
- Pasuritë e mia janë nën vlerën e 36 pagave minimale mujore të përcaktuar me ligj.

2.2.2 Për kërkuesin që jeton në një familje:

- Të ardhurat e familjes janë më të ulëta se 50% e pagës minimale mujore të përcaktuar me ligj.
- Pasuritë e familjes janë nën vlerën e 36 pagave minimale mujore të përcaktuar me ligj.

Përrjashtimisht, lidhur me subjektet e përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1, të neni 10 të ligjit 111/2017 për cdo aplikim do të kërkohet bashkëpunimi me autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët për të përcjellë dokumentacionin e nevojshëm.

2.3 Lloji i shërbimit:

☐ Përkthim zyrtar

☐ Interpretim i gjuhës së shenjave

RUBRIKA 3: DEKLARIME

① *Ju lutem lexoni me vëmendje përpara se të nënshkruani!*

1. Deklaroj se i gjithë informacioni që kam vënë në dispozicion, përmes kësaj kërkesë, është i vërtetë dhe i saktë. Jam i informuar se përbën shkelje në kuptim të legjisllacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë:
 - a) dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë / të pavërtetë;
 - b) paraqitja e dokumenteve false.
2. Deklaroj dhe pranoj se, nëse vërtetohet pasaktësia / falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë për çdo kosto të shkaktuar si rezultat i përfitimit pa të drejtë të uljes së tarifës ose përjashtimin nga pagesa e tarifës së shërbimit të përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar.
3. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë, vërtetësisë dhe efektshmërisë së tyre lidhur me

kërkesën time dhe se ky deklaram mund të shërbejë si autorizim për Ministrinë e Drejtësisë për të ndërmarrë çdo veprim me qëllim verifikimin e të dhënave të këtij formulari.

4. Deklaroj dhe pranoj se në vijim do të informoj mbi çdo informacion shtesë që do të ndryshojë statusin tim si përfitues.

RUBRIKA 4: DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Kjo kërkesë shoqërohet nga dokumentat si më poshtë:

A. Dokumenti i identifikimit të kërkuarit

B. Formulari i Vetëdeklarimit për Kategoritë e Veçanta (*shoqëruar me dokumentat bashkëlidhur*); ose
Formulari i Vetëdeklarimit të të Ardhurave dhe Pasurive (*shoqëruar me dokumentat bashkëlidhur*);

C. Lista e dokumentave të tjera:

çertifikatë familjare;

vërtetim papunësie;

vërtetim për trajtimin me ndihmë ekonomike;

vërtetim për trajtimin me KEMP;

vërtetimi mbi pasuritë e paluajtshme që disponon;

vërtetim page bruto dhe neto;

vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës që kryhet prej këtyre institucioneve

Nënshkrimi i Aplikantit

Z/Znj. _____
(emër-mbiemër-nënshkrim)

① Informacioni si më sipër, do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.



Shtojca nr. 2

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR TË ARDHURAT DHE PASURITË

RUBRIKA 1: VETËDEKLARIMI I TË ARDHURAVE DHE PASURIVE

1.1. Vetëdeklarim i kërkuarit që jeton vetëm:

1.1.1 Të ardhurat e kërkuarit:

- Të ardhura nga ☐ paga / ☐ pensioni në shumënLekë/muaj.
- Të ardhura nga qiraja e pasurisë së paluajtshme në shumënLekë/muaj.
- Të ardhura nga interesa huaje / interesa të depozitave bankare në shumën.....Lekë/muaj.
- Të tjera (specifiko burimet dhe shumat e përfituara):

.....

.....

.....

.....

.....

TË ARDHURAT E KËRKUESIT JANË NË VLERËN.....LEKË/MUAJ

1.1.2 Pasuritë e kërkuarit

Pasuri të luajtshme

(Psh. makina; kuota/aksione në shoqëri tregtare; depozita bankare etj.)

	Pasuria	Vlera e pasurisë
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		

Pasuri të paluajtshme

(Përveç banesës ku jeton kërkuari)

	Pasuria	Vlera e pasurisë
1		
2		
3		
4		

5		
6		
7		

PASURITË E KËRKUESIT JANË NË VLERËN.....LEKË/MUAJ

1.1.3 Shpenzime / kosto / detyrime të aplikantit

- Kosto banimi (qira) në shumënLekë/muaj;
- Detyrim ushqimor në shumënLekë/muaj;
- Pagesë e kredisë bankare në shumënLekë/muaj;
- Të tjera (*specifiko*):

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



- Nëse hapësira e mësipërme nuk mjafton, ju lutem vijoni në faqen në fund të këtij formulari.

DETYRIMET TOTALE TË APLIKANTIT JANË NË VLERËN.....LEKË/MUAJ.

1.2. Vetëdeklarim i kërkuarit që jeton me familjen

(të ardhurat; pasuritë dhe shpenzimet më poshtë do të konsiderohen të përbashkëta të kërkuarit dhe familjes)

1.2.1 Të ardhurat familjes:

Familja përbëhet nga persona, që përfitojnë të ardhura si më poshtë:

- Të ardhura nga paga / pensione:

1., në cilësinë e, i cili është ☐ i punësuar / ☐ në pension me të ardhura në shumën.....Lekë;

2., në cilësinë e, i cili është ☐ i punësuar / ☐ në pension me të ardhura në shumën.....Lekë;

3., në cilësinë e, i cili është ☐ i punësuar / ☐ në pension me të ardhura në shumën.....Lekë;

4., në cilësinë e, i cili është ☐ i punësuar / ☐ në pension me të ardhura në shumën.....Lekë;

5., në cilësinë e, i cili është ☐ i punësuar / ☐ në pension me të ardhura në shumën.....Lekë;

6., në cilësinë e, i cili është ☐ i punësuar / ☐ në pension me të ardhura në shumën.....Lekë;

Të ardhura nga qiraja e pasurisë së paluajtshme në shumënLekë/muaj;

Të ardhura nga interesa huaje / interesa të depozitave bankare në shumënLekë/muaj.

Të tjera (specifikoj burimet dhe shumën e përfituara):

.....

.....

.....

.....



- Nëse hapësira e mësipërme nuk mjafton, ju lutem vijoni në faqen në fund të këtij formulari.

TË ARDHURAT TOTALE TË FAMILJES JANË NË VLERËN.....LEKË/MUAJ

1.2.2 Pasuritë e familjes

Pasuri të luajtshme

(P.sh. makina; kuota/aksione në shoqëri tregtare; depozita bankare etj.)

	Pasuria	Vlera e pasurisë
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		

Pasuri të paluajtshme
(Përveç banesës ku jeton familja)

	Pasuria	Vlera e pasurisë
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		

PASURITË TOTALE TË FAMILJES JANË NË VLERËN.....LEKË/MUAJ

1.2.3 Shpenzime / kosto / detyrime të familjes

- Kosto banimi (*qira*) në shumënLekë/muaj;
- Detyrim ushqimor në shumënLekë/muaj;
- Pagesë e kredisë bankare në shumënLekë/muaj;
- Të tjera (*specifiko*):

.....

.....

.....

.....

- Nëse hapësira e mësipërme nuk mjafton, ju lutem vijoni në faqen në fund të këtij formulari.

DETYRIMET TOTALE TË FAMILJES JANË NË VLERËN.....LEKË/MUAJ.

RUBRIKA 2: DEKLARIME

① *Ju lutem lexoni me vëmendje përpara se të nënshkruani!*

1. Deklaroj se i gjithë informacioni që kam vënë në dispozicion, përmes këtij formulari, është i vërtetë dhe i saktë. Jam i informuar se përbën shkelje në kuptim të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë:
 - a) dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë / të pavërtetë;
 - b) paraqitja e dokumenteve false.
2. Deklaroj dhe pranoj se, nëse vërtetohet pasaktësia / falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë për çdo kosto të shkaktuar si rezultat i përfitimit pa të drejtë të uljes së tarifës ose përjashtimin nga pagesa e tarifës së shërbimit të përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar.
3. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë, vërtetësisë dhe efektshmërisë së tyre lidhur me aplikimin tim dhe se ky deklaram mund të shërbejë si autorizim për Ministrinë e Drejtësisë për të ndërmarrë çdo veprim me qëllim verifikimin e të dhënave të këtij formulari.
4. Deklaroj dhe pranoj se në vijim do të informoj mbi çdo informacion shtesë që do të ndryshojë statusin tim si përfitues.

RUBRIKA 3: DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Ky aplikim shoqërohet nga dokumentat si më poshtë:

A. Dokumente që vërtetojnë të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet:

.....;
.....;
.....;
.....;
.....;
.....;
.....;

B. Dokumente të tjera:

.....;
.....;
.....;
.....;
.....;
.....;

Nënshkrimi i Aplikantit

Z/Znj. _____
(emër-mbiemër-nënshkrim)

① Informacioni si më sipër, do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale



FORMULAR VETEDEKLARIMI PER KATEGORITË E VEÇANTA TË PËRFITUESVE

RUBRIKA 1: VETËDEKLARIM I KATEGORIVE TË VEÇANTA TË PËRFITUESIT

Përzgjidhni më poshtë kategorinë ku bëni pjesë.

1. Viktimë e dhunës në familje ☐ Po ☐ Jo
2. Viktimë e abuzimit seksual dhe/ose trafikimit të qënieve njerëzore ☐ Po ☐ Jo
3. Viktimë e mitur dhe/ose në konflikt me ligjin ☐ Po ☐ Jo
4. Femijë që jeton në institucionet e përkujdesit shoqëror ☐ Po ☐ Jo
5. Femijë nën kujdestari, që kërkon të nisë një proces pa miratimin e kujdestarit ligjor dhe/ose kundër kujdestarit ligjor ☐ Po ☐ Jo
6. Person që përfiton nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit ☐ Po ☐ Jo
7. Person, nën trajtim të pavullnetshëm në një nga institucionet e shërbimit të shëndetit mendor ☐ Po ☐ Jo
8. Person, nën trajtim vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore ☐ Po ☐ Jo
9. Person, ndaj të cilit kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar ☐ Po ☐ Jo
10. Person te cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkon të nisë një proces kundër kujdestarit ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor ☐ Po ☐ Jo
11. Person i cili përfiton nga skemat e mbrojtjes sociale; ☐ Po ☐ Jo
12. Person të cilit i është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent; ☐ Po ☐ Jo

RUBRIKA 2: DEKLARIME

① *Ju lutem lexoni me vëmendje përpara se të nënshkruani!*

1. Deklaroj se i gjithë informacioni që kam vënë në dispozicion, përmes këtij formulari, është i vërtetë dhe i saktë. Jam i informuar se përbën shkelje në kuptim të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë:
a) dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë / të pavërtetë;
b) paraqitja e dokumenteve false.
2. Deklaroj dhe pranoj se, nëse vërtetohet pasaktësia / falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë për çdo kosto të shkaktuar si rezultat i përfitimit pa të drejtë të uljes së tarifës ose përjashtimin nga pagesa e tarifës së shërbimit të përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar.
3. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë, vërtetësisë dhe efektshmërisë së tyre lidhur me aplikimin tim dhe se ky deklaram mund të shërbejë si autorizim për Ministrinë e Drejtësisë për të ndërmarrë çdo veprim me qëllim verifikimin e të dhënave të këtij formulari.
4. Deklaroj dhe pranoj se në vijim do të informoj mbi çdo informacion shtesë që do të ndryshojë statusin tim si përfitues.

RUBRIKA 3: DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Ky aplikim shoqërohet nga dokumentat si më poshtë:

A. Dokumente që vërtetojnë statusin e kategorisë së veçantë:

.....;
.....;
.....;
.....;
.....;

B. Dokumente të tjera:

.....;
.....;
.....;
.....;
.....;

Nënshkrimi i Aplikantit

Z/Znj. _____
(emër-mbiemër-nënshkrim)

① Informacioni si më sipër, do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale

DEKLARATA E MARRJES SË SHËRBIMIT

Data ____ . ____ . ____

Unë, _____, përfitues i ☐ uljes së tarifës / ☐ përjashtimit nga pagesa e tarifës së shërbimit të përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave për gjuhën sipas ☐ njoftimit të Ministrisë së Drejtësisë / ☐ urdhrit të Ministrit të Drejtësisë me nr. _____ datë _____, deklaroj se mora shërbimin e ☐ përkthimit zyrtar / ☐ interpretimit të gjuhës së shenjave nga ☐ përkthyesi zyrtar / ☐ interpreti i gjuhës së shenjave nga i certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. _____ datë ____ . ____ . ____ dhe regjistruar në Regjistrin Elektronik të Përkthyesve Zyrtarë me nr. _____.

Gjithashtu, deklaroj se informacioni i sipërcituar është i vërtetë dhe i saktë. Jam i informuar se përbën shkelje në kuptim të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë:

- a) dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë / të pavërtetë;
- b) paraqitja e dokumenteve false.

Deklaroj dhe pranoj se, nëse vërtetohet pasaktësia / falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë për çdo kosto të shkaktuar si rezultat i përfitimit pa të drejtë të uljes së tarifës ose përjashtimit nga pagesa e tarifës së shërbimit të përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar.

Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë, vërtetësisë dhe efektshmërisë së tyre dhe se kjo deklaratë mund të shërbejë si autorizim për Ministrinë e Drejtësisë për të ndërmarrë çdo veprim me qëllim verifikimin e të dhënave të kësaj deklarate.

Z/Znj. _____
(emër-mbiemër-nënshkrim)